

ROGAT SECURITY GROUP Sh.p.k

PASQYRAT FINANCIARE

(Mbështetur në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", të ndryshuar, dhe në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit – SKK 2)

Të dhëna identifikuese

Emri **ROGAT SECURITY GROUP Shpk**
TIRANE

- NIPT **K 31526053M**

-Adresa **Rruga KAVAJES 100** vitrinat
Tirane

- Data e krijimit **21.09.1995**

- Nr Regj Tregt **12219**

- Fusha e veprimtarisë **SHRSF(Sig,i**
objekt, publike ,private, lidhje sist.vrojtimi
pajse nderlidhje)_

Të dhëna të tjera

Individuale
- Pasqyra financiare
 Të
konsoliduara

- Monedha **LEK**

- Rrumbullakimi

- Periudha Kontabël
Nga 01.01.2013 Deri 31.12.2013

- Data e plotësimit të PF **13.03.2014**

[Signature]


ROGAT SECURITY GROUP SH.P.K

AKTIVET

Nr. Ref.	AKTIVET	Viti Ushtrimor	
		30 DHJETOR 2013	31 DHJETOR 2012
I	Aktive Afatshkurtra	50,979,462	38,910,959
1	Mjetet Monetare	1,586,646	1,284,304
	ARKE	27,199	83,188
	BANKE	1,559,447	1,201,116
2	Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim		-
a)	Derivatet		-
b)	Aktivete e mbajtur per tregtim		-
	Totali 2	-	-
3	Aktive te tjera Financiare afatshkurter	7,237,608	11,831,001
a)	Llogari kerkesa te arketueshme KLIENTE	6,591,691	11,247,136
b)	Llogari kerkesa te tjera te arketueshme TATIM FITIMI	581,026	583,865
c)	Instrumente te tjera borxhi(Ortaku)		
d)	Investime te tjera financiare Fond Ngurtesimi	64,890	
	Totali 3	7,237,608	11,831,001
4	Inventari	42,155,208	25,001,354
a)	Materiale Lende e pare per VR	1,249,506	1,249,606
b)	Inventar ne perdorim te trete	8,126,244	7,760,783
c)	Inventari	1,139,981	1,199,980
d)	Mallra per rishitje	31,639,377	14,790,985
e)	Parapagesat per furnizime		
	Totali 4	42,155,208	25,001,354
5	Aktive Biologjike afatshkurter		
6	Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje		
7	Parapagime dhe shpenzime te shtyra		794,300
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	50,979,462	38,910,959
II	Aktive Afatgjate		
1	Investime financiare afatgjate		
a)	Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara		
b)	Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje		
c)	Aksione dhe letra te tjera me vlere		
c)	Llogari kerkese te arketueshme		
	Totali 1		
	Aktive Afatgjate Materiale	45,997,165	15,275,145
a)	Toka		
b)	Ncertesa (neto) VEND ROJE dhe ZYRAT	27,180,022	983,771
c)	Makineri dhe pajisje (neto)	702,982	739,982
c)	Te tjera	4,285,390	2,717,453
d)	Aktive te tjera afatgjate materiale (neto)(Mjete transp.)	13,828,771	10,833,939
	Totali 2	45,997,165	15,275,145
3	Aktive Biologjike Afatgjate		
4	Aktive Afatgjate Jomateriale		
a)	Emri i mire		
b)	Shpenzimet e zhvillimit		
c)	Aktive te tjera afatgjate jomateriale	990,276	822,301
	Totali 4	990,276	822,301
5	Kapitali aksionar i papaguar		
6	Aktive te tjera afatgjate (ne proces)		
	Totali i Aktiveve Afatgjate	46,987,441	16,097,446
	TOTALI AKTIVEVE	97,966,903	55,008,405



ROGAT SECURITY GROUP SH.P.K

DETYRIMET DHE KAPITALI

Nr. Ref.	DETYRIMET DHE KAPITALI	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
I	Detyrimet Afatshkurtra		
1	Derivatet	9,370,616	8,377,651
2	Huamarrjet		
a)	Huate dhe obligacionet afatshkurtra	-	-
b)	Kthimet/Ripagimet e huave afatgjata	-	-
c)	Bono te konvertueshme	-	-
	Totali 2	-	-
3	Huate dhe parapagimet	9,370,616	8,377,651
a)	Te pagueshme ndaj furnitoreve	8,735,166	7,007,452
b)	Te pagueshme ndaj punonjesve	0	966,064
c)	Detyrime per Sig:shoqerore	299,367	270,034
c)	Detyrime per TAP	5,000	54,118
d)	Detyrime Tatim dividenti	301,915	28,400
	Totali 3	9,341,448	8,377,651
4	Grantet dhe te ardhura te tjera Parapagime	29,168	
5	Provizionet afatshkurtra		
	Detyrime Totale Afatshkurtra	9,370,616	8,377,651
II	Detyrimet Afatgjata		
		75,798,054	35,149,028
1	Huate afatgjata		
a)	Hua te Tjera Debitor, Kredit, tjere	32,000,550	20,200,000
b)	Hua per ZYRAT	26,245,440	
c)	ORTAK Divident per te paguar	255,592	255,592
	Totali 1	58,501,582	20,455,592
2	Huamarrje te tjera afatgjata Qera Financiare	2,317,856	732,185
3	Overdraft Intesa Bank	5,608,000	5,583,600
4	Te ardhura te tjera	0	
	Detyrime Totale Afatgjata	66,427,438	26,771,377
	Detyrime Totale	75,798,054	35,149,028
III	Kapitali		
		22,168,849	19,859,377
1	Akisonet e pakices		
2	Kapitali i aksionereve te shoqerise meme		
3	Kapitali i aksionar	4,000,000	4,000,000
4	Primi i aksionit		
5	Njesite ose aksionet e thesarit		
6	Rezerva statutore		
7	Rezerva ligjore	505,275	505,275
8	Rezerva te tjera		
9	Fitimi i pashperndare	15,354,102	12,894,906
10	Fitimi (humbje) e vitit financiar	2,309,472	2,459,196
	Totali i Kapitalit	22,168,849	19,859,377
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	97,966,903	55,006,405

ROGAT SECURITY GROUP SH.P.K

A- PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE (Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)

Nr. Ref.	Pershkrimi	Viti Ushtrimor	Viti Paraardhes
		31DHJETOR 2013	31DHJETOR 2012
	Te Ardhurat	65,329,610	72,037,210
1	Shitjet neto	64,909,610	71,931,010
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit SHITJE AAM	420,000	106,200
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		
4	Materialet e konsumuara	(28,659,458)	(31,299,920)
5	Kosto e punës	(13,152,833)	(11,870,193)
a)	-pagat e personelit	(11,231,824)	(10,170,481)
b)	-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	(1,921,009)	(1,699,712)
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet	(1,317,929)	(2,951,283)
7	Shpenzime të tjera	(16,746,121)	(21,880,831)
8	Shpenzime te Panjohura fiskale	(1,609,409)	(813,668)
9	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)	(61,485,751)	(68,815,895)
10	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)	3,843,859	3,221,315
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		
13	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	(1,098,956)	(410,267)
13/a	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata SHITJE AAM	(504,000)	
13/b	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	(531,276)	(178,017)
13/c	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	(63,680)	(232,250)
13/d	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare SHITJE AAM		
14	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)	(1,098,956)	(410,267)
	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	2,744,903	2,704,848
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 10%	435,431	(351,852)
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	2,309,472	2,459,196

ROGAT SECURITY GROUP Sh.p.k

PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT

(b) Në një pasqyrë të pakonsoliduar

Levizja e Kapitaleve	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2011	4,000,000			326,775	13,357,398	17,684,173
Frekti i ndryshimeve në politikat kontabël						
Pozicioni i rregulluar						
Fitimi neto për periudhën kontabël					2,459,196	2,459,196
Dividendët e paguar						
Rritje e rezervës së kapitalit				178,500	(462,492)	(283,992)
Emetimi i aksioneve						
Pozicioni më 31 dhjetor 2012	4,000,000	-	-	505,275	15,354,102	19,859,377
Fitimi neto për periudhën kontabël					2,309,472	2,309,472
Dividendët e paguar						
Zmadhim i kapitalit aksionar						
Ritja e rezervës së kapitalit						
Pozicioni më 31 Dhjetor 2013	4,000,000	-	-	505,275	17,663,574	22,168,849

ROGAT SECURITY GROUP SH.P.K

PASQYRA E FLUKSIT MONETAR (METODA INDIREKTE)

PASQYRA E FLUKSIT MONETAR - METODA INDIREKTE 2013

Nr		Perudha Raportuese 2013	Perudha Raportuese 2012
A	FLUKSI MONETAR NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	32,510,265	2,064,500
1	Fitimi para tatimit	2,744,903	2,704,848
2	Rregullime per :		
	Amortizimin	1,317,929	2,951,283
	Humbje nga kembimet valutore		
	Te ardhura nga Investimet		
	Shpenzime per interesa		
3	Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	4,593,393	-7,702,542
4	Rritje/renie ne Tepricen e inventarit	-16,359,554	-13,638,132
5	Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve ,per tu paguar nga aktiviteti	40,649,025	18,278,686
6	MM te perfituara nga aktivitetet		-177,791
7	rezerva te krijuara		
8	Tatim mbi fitimin i paguar	-435,431	-351,852
9	MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit		
B	FLUKSI MONETAR NGA VEPRIMTARITE INVESTUESE	-32,207,924	-4,881,877
1	Blerja e njesise kontrolluar X minus parate e Arketuara		
2	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	-32,207,924	-4,881,877
3	Te ardhura nga shitja e paisjeve		
4	Interesi i arketuar		
5	Dividentot e arketuar		
6	MM neto te perdorura ne veprimtarite investuese		
C	FLUKSI MONETAR NGA AKTIVITETET FINANCIARE		
1	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		
2	Te ardhura nga huamarrje afatgjata		
3	Pagesat e detyrimeve te qerase financiare		
4	Dividente te paguar		
5	MM neto e perdorur ne veprimtarite Financiare		
D	Rritja/Renia neto e mjeteve monetare	302,341	-2,817,377
E	Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	1,284,305	4,101,682
H	Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	1,586,646	1,284,305

A handwritten signature in blue ink is placed over a circular stamp. The stamp contains the text 'ROGAT SECURITY GROUP SH.P.K.' around the perimeter and '14002' in the center.

SHENIME SHPJEGUESE

Shoqëria "ROGAT SECURITY GROUP" Shpk i ka ndertuar Pasqyrat Financiare për vitin 2013 në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK2. Kjo është hera e katërt që shoqëria i ndërton dhe i paraqet Pasqyrat Financiare sipas SKK në bazë të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 4. Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar **Politikat Kryesore Kontabël** si : politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave e shpenzimeve si dhe njohjen dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë pasur parasysh **Parimet** informacionit: si Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i Njesise Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimesise së veprimtarise ekonomike si dhe Parimi i Kompesimit. **Karakteristikat** cilesore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë ato që e bëjnë informacionin e pasqyrave financiare të dobishëm për përdoruesin. Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2013 janë : Kuptueshmëria, Rendësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i Paraqitjes me Besnikëri, parimi i Përparesise së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore, Paanshmëria, Parimi i maturise, Parimi i plotësisë. Qendrushmëria dhe Krahasueshmëria .

Përmbledhje e politikave kontabël

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar " Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të konstatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit zbatohen prej disa vitesh dhe aplikimi i tyre, sipas kërkesave të SNK-ve, është bërë në mënyrë perspektive. Si pasojë shifrat e 2013 janë të krahasueshme me ato të vitit 2012, pasi janë zbatuar politika kontabël të njejta.

Në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2013 është zbatuar formati i SKK-2 si edhe në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2012.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lek, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore më 31.12.2013 janë 1 euro=140,20 lekë dhe 1 dollar=101.86 lekë.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshëm për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm i cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2013 është 10 %.

Kerkesat për t'u arketuar

Kerkesat për t'u arketuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arketuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuara. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arketuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme.

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në para, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme.

Aktivët Afatgjatë Materiale

Aktivët afatgjatë materiale (AAM-të) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndërtesat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura janë nënë baze të Ligjit të Tatimeve.

Gjendjet e inventarët

Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është cmuar si vlera neto e realizueshme.

Ne vijim do të interpretojmë vlerat e paraqitura në pasqyrat përkatëse.

AKTIVET

Bilanci Kontabël nis me Zeri I.1. *Aktive monetare* të cilat arrijnë në fund të vitit vlerën 1,586,646 leke. Zëri I.3. (i) paraqet vlerën e *Kerkesave te arketueshme nga klientet* per 6,591,691 leke, Zeri I.3. (ii) *Kerkesa te tjera te Arketueshme* Tatim Fitimi derdhur me shume per 581,026 leke . Zeri I.4. (iii) *Investime te tjera Fond Ngurtesimi ne BKT* 64,890 leke Zeri 1.4 a) *Materiale L e pare* 1,249,606 leke *Materiale per vend roje*. Zëri I.4. (d) *Mallra Per Rishitje* paraqet vlerën e *mallrave* gjendjen në magazinë prej 31,639,377 leke. Zëri I.4. (b) *Inventar ne perdorim tek te Tretet* prej 8,126,244 leke perfaqesojne vleren e mallrave te instaluar nga ana jone ne objektet sipas kontratave .Zeri 4.c) *Inventar* prej 1,139,981 leke perfaqeson inventar ne perdorim ne zyre. Për të vlerësuar mallrat është ndjekur politika e vlerësimit të inventarit me cmimin mesatar.

Totali i Aktiveve Afatshkurtera per 50,979,462 leke

AKTIVET AFATGJATA

Zeri II.b.(iii) *Ndertesa* perfaqeson Vleren e Zyrave te blera ne 2013 prej 26,245,440 Leke dhe Vend Rojet me vleren e mbetur prej 934,582 leke ne fund te vitit 2013.

Zeri II.c.(iii) *Makineri e Paisje* perfaqeson vleren e mbetur te AQT (makineri e paisje)per 702,982 leke nga vlera ne fund te 2012 prej 739,982 leke dhe shtesat prej 0 leke eshte zbritur amortizimi deri ne fund te vitit 2013 per 36,999 leke. Zeri II.2.(c) *Aktive te tjera afatgjata materiale* perfaqeson vleren e mbetur te paisjeve te zyles e atyre informatike per 4,285,390 leke pra vlera e mbetur ne 2012 prej 2,717,453 leke dhe shtesat ne 2013 prej 1,792,999 leke minus amortizimin e akumuluar ne 2013 per 225523 leke, dhe Zeri II.2.d *Mjete Transporti* qe perfaqeson vleren e mbetur te Mjeteve te Transportit prej 13,828,771 leke deri ne fund te vitit 2013 nga diferenca midis vleres ne fund te 2012 prej 10,833,939 leke plus shtesat prej 5,882,379 leke ne 2013 me amortizimin prej 558,181 leke, dhe shitjes prej 2,328,907 leke gjate vitit 2013. Zeri III.c.(iii) *Aktive te tjera afatgjate jomateriale* perfaqeson Program Kompjuterik me vleren te mbetur 990,276 leke nga diferenca e vleres fillestare 822,301 leke.

Totali i Aktiveve Afatgjata per 46,987,441 leke

AKTIVET TOTALI 97,966,903 leke

DETYRIMET DHE KAPITALI

DETYRIMET

Për pjesën e detyrimeve Zërin I.3.(a) *Te pagueshme ndaj furnitoreve* perfaqeson detyrimet e shoqerise ndaj furnitorëve per 8,735,166 leke te cilet jane të gjithë furnitorët ende te palikujduar deri në fund të vitit 2013. Zeri I .3.(b) *Te pagueshme ndaj punonjesve* perfaqeson pagat e punonjesve te shoqerise te muajit dhjetor qe jane 0 leke dhe Dieta prej 0 leke. Zeri I .3.(b/1) *Detyrime per Sigurimet shoqerore per muajin Dhjetor 2013* per 299,367 leke Zeri I3(c) janë detyrimet per TAP te punonjesve per Dhjetor 2013 per 5000 leke, Zeri I 3(D) *Detyrime te shoqerise per TVSH* per 301,915 leke, detyrime keto të muajit dhjetor të cilat do të likujdohen ne fillim te vitit pasardhës. Zeri I .4. *Grande dhe te Ardhura te Shtyra* prej 29,168 leke jane te ardhura qe i takojne vitit ne vazhdim. Zëri II.1.(i) *Hua, bono dhe detyrime nga Debitore Kreditore te tjere* ne vleren 32,000,550 lekë ,dhe Zeri II.2 *Hua per Zyrat e blera ne 2013 per Vleren* 26,245,440 leke dhe Zeri II.1 (B) *Hua te tjera Pronari Divident* prej 255,592 leke. Zeri .2. *Huamarje te tjera Qera Financiare* prej 2,317,856 leke, mjete te mare nga Landeslease, Zeri .3. *Overdraft Intesa Bank* ne vleren 5,608,000 leke

ROGAT SECURITY GROUP SHPK Sh.p.k

Totali i Detyrimeve per 75,798,054 leke

KAPITALI

Zeri III. 3. *Kapitali Aksionar* në vlerën 4 000 000 leke perfaqeson vleren e kapitalit te nenshkruar. Zeri III. 7. *Rezerve Ligjore* prej 505,275 leke krijuar me Vendim Ortaku nga viti 2012. Zeri III. 9. *Fitimi i Pashperndare* prej 15,354,102 leke. Zeri III.10. *Fitimi (Humbja) e vitit financiar* perfaqeson fitimin e shoqerise në vlerën 2,309,472 leke e krijuar vetem ne vitin 2013

Totali i Kapitalit per 22,168,849 leke

DETYRIMET DHE KAPITALI TOTALI 97,966,903 leke

TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzime e ndërtuar sipas Natyrës, fillon me :Zëri 1. *Shitjet neto* të cilat për vitin 2013 janë 65,329,610 lekë nga te cilat 420,000 leke jane te ardhura e shitjes se AAM gjate vitit 2013. Zeri 4. *Materialet e konsumuara* per 28,659,458 leke perben vleren e blerjes se mallrave gjate vitit 2013 si dhe gjendjet e inventarit te perdorura duke ndjekur edhe në dalje politikën e vlerësimit të inventarëve me metoden mesatare. Zeri 5. *Kosto e punës* për këto shitje arrin në vlerën prej 13,152,833 leke, nga te cilat për *pagat e punonjësve* 11,231,824 leke dhe 1,921,009 leke, për *sigurimet shoqërore* që paguan njësia në emër të punonjësve. Zeri 6. *Amortizime dhe zhvleresime* shoqëria ka llogaritur 1,317,929 leke amortizim per vitin 2013. Zeri 7. *Shpenzimeve të tjera* per 16,746,121 leke janë Shpenzimet per Furnitura nentrajtme e sherbime,shpenzimet per tatime e taksa te tjera . Zeri .8 Spenzime te panjohura 1,609,409 jane shpenzime mbi koston e AAM te shitur ne 2013 dhe te tjera ,Zeri 9. *Fitim apo humbja nga veprimtaria kryesore* per 3,843,859 leke perfaqeson diferencen e Te ardhurave nga shitja me shpenzimet direkte te ushtrimit. Zeri 12. *Te ardhura ose Shpenzime financiare* jane shpenzime per 1,098,956 leke dhe perbehen nga: Zeri 13/shitje AAM prej 504,000 leke, Zeri 13/b *Sshpenzimet nga interesat* 531,276 leke,dhe Zeri 13/c. *Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit* si rezultat i transaksioneve në valutë (Humbje) prej 63,680 leke.

Për gjithë veprimtarinë e kryer gjatë vitit korrent shoqëria ka shpenzuar për detyrim ndaj shtetit në formën e tatim fitimit per 432,592 leke. Nga krahasimi vlerave te mesiperme ,duke pasur parasysh dhe Tatim Fitimin e derdhur teper nder vite prej 583,865 leke i mbartur nder vite del *rezultati i vitit (fitimi)* prej 2,309,472 leke, shifër e cila është e transferuar edhe ne bilancin kontabël në zërin përkatës te rezultatit te ushtrimit.

REZULTATI I VITIT USHTRIMOR (FITIMI) 2,309,472 LEKE

HARTOI

Majlinda DERVISHI

ADMINISTRATORI

Ilir MANE

Raport Auditimi

PER

DEKLARIMET FINANCIARE

VITI USHTRIMOR 2013

A

**SHOQERIA "ROGAT SECURITY GROUP" SHPK
TIRANE**

Perg. H Leka

Tirane me 22.05.2014

Ky raport permban 13 faqe.

RAPORT
I
AUDITUESIT TE PAVARUR

PER ORTAKET E SHOQERISE "ROGAT SECURITY GROUP" SHPK TIRANE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te Shoqerise " Rogat Security Group" Shpk per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2013 dhe pasqyrat perkatese te te ardhurave dhe te fluksit te parase per kete ushtrim.

Pergjegjësia e drejtimit per Pasqyrat Financiare.

Pergatitja e ketyre pasqyrave financiare eshte pergjegjesi e Drejtimit te Shoqerise ne perputhje me ligjin Nr 9228 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare" dhe Standartet kombetare te Kontabilitetit. Kjo Pergjegjesi perfshin Hartimin, zbatimin dhe organizimin e kontrollit te brendshem te pershtatshem, mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te Pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabim i zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel dhe kryerjen e cmuarjeve kontabel te arsyeshme per rrethanat.

Pergjegjësia e Audituesit.

Pergjegjësia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion te pavarur mbi keto pasqyra financiare.

Ne e kryem auditimin ne pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Keto standarte kerkojne qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin ekzaminimin, mbi bazen e testeve, te evidences qe mbeshitet shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare.

Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabile te perdorura dhe te cmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se auditimi jep nje baze te arsyeshme per opinionin tone.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte per gjendjen financiare te shoqerise me date 31 Dhjetor 2013, rezultatet e veprimtarise te saj per ushtrimin e mbyllur, jane ne pajtim me ligjit nr 9228 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

